



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ  
Nr. \_\_\_\_/2016**

**“PËR ARBITRAZHIN NDËRKOMBËTAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI I**

**REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për arbitrazhin ndërkombëtar tregtar, duke iu nënshtuar çdo marrëveshje në fuqi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe çdo shteti ose shteteve të tjera.
2. Dispozitat e këtij ligji përveç neneve 9, 10, 26, 26, 27, 28, 46 dhe 47, zbatohen vetëm nëse vendi i arbitrazhit është territori i Republikës së Shqipërisë.
3. Për efekt të zbatimit të këtij ligji termi "tregtar" ka kuptimin e çështjeve që rrjedhin nga të gjitha marrëdhëniet e natyrës tregtare qofshin këto kontraktuale ose jo duke mos u kufizuar vetëm në to si transaksionet tregtare për furnizimin ose shkëmbimin e mallrave dhe shërbimeve, kontratat e specicionit, përfaqësimit ose agjencive tregtare, dhënies me qira; këshillimit, licencimit, investimeve, financimit, veprimit bankar, sigurimit, të shfrytëzimit apo koncensionit, të shoqërive aksionere dhe forma të tjera të bashkëpunimit industrial apo tregtar; të ndërtimit të veprave, transportit të mallrave dhe pasagjerëve nga ajri, deti, dhe toka.
4. Një arbitrazh është ndërkombëtar nëse:
  - a. Palët në një marrëveshje arbitrazhi, në kohën e lidhjes së saj kanë vendin e ushtrimit të veprimtarisë së tyre tregtare në shtete të ndryshme; ose
  - b. Vendi i arbitrazhit, kur ky është i përcaktuar në marrëveshjen e arbitrazhit ndodhet jashtë Shtetit në të cilin palët kanë të regjistruar selitë e tyre;

- c. Palët kanë rënë dakord shprehimisht se objekti i marrëveshjes së arbitrazhit ka lidhje me më shumë se një vend.
5. Për qëllime të paragrafit (4) të këtij neni:
  - (a) nëse një palë ka më shumë se një vend të ushtrimit të aktivitetit, vendi i ushtrimit të aktivitetit është ai që ka afërsi më të marrëveshjes së arbitrazhit;
  - (b) nëse një palë nuk ka një vend të ushtrimit të aktivitetit, referimi bëhet aty ku ka vendbanimin/qëndrimin e tij të zakonshëm
6. Ky ligj nuk ndikon në asnjë ligj tjetër të Republikës së Shqipërisë në bazë të cilit disa mosmarrëveshje janë të paarbitrueshme ose janë të arbitrueshme vetëm në përputhje me dispozita të ndryshme nga ato të këtij ligji.

## **Neni 2 Përkufizime**

1. Për qëllime të këtij ligji:
  - a. "arbitrazh" nënkupton çdo procedurë arbitrazhi pavarësisht nëse ajo zhvillohet nga një Institucion Arbitrazhi i Përhershëm,
  - b. "gjykatë arbitrazhi" nënkupton një gjyqtar të vetëm ose një trup gjyqtarësh;
  - c. "Gjykatë" nënkupton një strukturë ose organ të sistemit gjyqësor të Republikës së Shqipërisë;
  - d. "Institucion i përhershëm arbitrazhi" nënkupton një institucion të themeluar sipas ligjit shqiptar që ka si qëllim të aktivitetit të tij organizimin e procedurave të arbitrazhit;
  - e. "Marrëveshje arbitrazhi" është marrëveshja midis palëve për të zgjidhur nëpërmjet arbitrazhit të gjitha ose disa mosmarrëveshje të cilat kanë lindur ose mund të lindin ndërmjet tyre në lidhje me një marrëdhënie juridike të përcaktuar, qoftë kjo kontraktuale ose jo, e parashikuar në formën e një klauzole arbitrazhi në një kontratë ose në formën e një kontrate të veçantë.

## **Neni 3 Rregulla interpretimi**

1. Kur një dispozitë e këtij ligji, përveç nenit 39, parashikon të drejtën e palëve për të vendosur mbi një çështje të caktuar, palët mund të autorizojnë një palë të tretë qoftë kjo dhe një institucion, për ta ushtruar këtë të drejtë.
2. Kur një dispozitë e këtij ligji i referohet faktit se palët kanë rënë dakord ose që ato mund të bien dakord ose në çdo mënyrë tjetër i referohet një marrëveshje të palëve, kjo marrëveshje përfshin çdo rregull të arbitrazhit të referuar në këtë të fundit.
3. Kur një dispozitë e këtij ligji përveç germës "a" të nenit 36 dhe të germës "a", paragrafi 2 të nenit 43 i referohet një padie, ajo gjithashtu zbatohet për një kundërpadi, dhe kur ajo i referohet një akti procedural mbrojtjeje ajo gjithashtu zbatohet dhe ndaj një akti mbrojtjeje ndaj një kundërpadie.
4. Në interpretim të këtij ligji, duhet të mbahet në konsideratë karakteri i tij ndërkombëtar dhe nevoja për të nxitur uniformitetin në zbatimin e tij dhe respektimin e parimit të mirëbesimit. Pyetjet në lidhje me çështje që rregullohen nga ky ligj të cilat nuk janë përcaktuar shprehimisht në të, duhet të përcaktohen në përputhje me parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet ky ligj.

## **Neni 4 Njoftimi i komunikimeve me shkrim**

1. Përveç kur palët bien dakord ndryshe:

- a) Çdo komunikim me shkrim konsiderohet të jetë njoftuar nëse i është dorëzuar marrësit personalisht, në vendin e tij të punës, vendqëndrimin e tij të zakonshëm ose adresën postare; nëse asnjë nga palët nuk mund të gjendet pas një kërkimi të arsyeshëm, njoftimi i një komunikimi me shkrim konsiderohet të jetë kryer nëse ai është dërguar në vendin e punës, vendqëndrimin e zakonshëm ose adresën postare të marrësit të njohur së fundi nëpërmjet postës së regjistruar;
  - b) Njoftimi i komunikimit prezumohet të jetë marrë në ditën që është dorëzuar sipas procedurave të parashikuara në gërmën "a" të këtij neni.
2. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për njoftimet në proceset gjyqësore të cilat rregullohen nga Kodi i Procedurës Civile.

### **Neni 5**

#### **Heqja dorë nga e drejta për të kundërshtuar**

1. Nëse pala që është në dijeni të shkeljes së një dispozite të këtij ligji apo të mospërbushjes së një kërkesë të parashikuar në marrëveshjen e arbitrazhit nga pala tjetër dhe vazhdon ende procesin e arbitrazhit duke mos paraqitur kundërshtim në lidhje me këtë shkelje apo mospërbushje menjëherë ose brenda afatit të caktuar për paraqitjen e tyre, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e saj për të kundërshtuar marrëveshjen e arbitrazhit.

### **Neni 6**

#### **Ndërhyrjet e gjykatës**

1. Asnjë gjykatë nuk mund të ndërhyjë në çështjet e rregulluara nga ky ligj, përveç kur në të parashikohet ndryshe.

### **Neni 7**

#### **Kompetencat mbështetëse apo mbikëqyrëse të gjykatës dhe Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit**

1. Kompetencat e referuara në nenet 12 paragrafi (3), 12 paragrafi (4), 14 paragrafi (3), 15, 17 paragrafi (3), 26, 27 dhe 28 kryhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ose një institucion i përhershëm i arbitrazhit. Funkcionet e referuara në nenin 45 paragrafi (2), 46, 47 kryhen nga Gjykata e Apelit.

## **KREU II**

### **MARRËVESHJA E ARBITRAZHIT**

#### **Neni 8**

##### **Forma e marrëveshjes së arbitrazhit**

1. Marrëveshja e arbitrazhit bëhet me shkrim. Marrëveshja e arbitrazhit konsiderohet e shkruar nëse përmbajtja e saj është e dokumentuar dhe e nënshkruar nga palët, ose është e dokumentuar nga këmbimi i letrave, teleksit, apo mënyrave të tjera të komunikimit të cilat mund të dokumentohen.

2. Referimi në një kontratë i një dokumenti që përmban një klauzolë arbitrazhi përbën një marrëveshje arbitrazhi me kusht që kontrata të jetë më shkrim dhe referimi të jetë i tillë që t'a bëjë atë klauzolë pjesë të kontratës.

### **Neni 9**

#### **Marrëveshja e arbitrazhit dhe e drejta e ngritjes së padisë para gjykatës**

1. Gjykata, para së cilës është ngritur një padi në një çështje që është objekt i një marrëveshje arbitrazhi, nëse një palë e kërkon këtë jo më vonë se sa kur dorëzon prapësimet me shkrim mbi themelin e çështjes, i referon palët në arbitrazh përveç kur konstaton se marrëveshja është e pavlefshme, inekzistente apo e pamundur për tu përmbushur.
2. Kur ngrihet një padi sipas përcaktimit të bërë në paragrafin 1 të këtij neni, procedurat e gjykimit të arbitrazhit, mund të fillojnë apo vijohen, në përfundim të të cilave mund të merret një vendim, ndërkohë që çështja e ngritur para gjykatës, është pezulluar për gjykim.

### **Neni 10**

#### **Marrëveshja e arbitrazhit dhe marrja e masave për sigurimin e padisë**

1. Nuk është në mospërputhje me marrëveshjen e arbitrazhit që secila nga palët pjesëmarrëse në një marrëveshje arbitrazhi, para ose gjatë gjykimit të arbitrazhit, të kërkojë nga gjykata marrjen e një mase paraprake për sigurimin e padisë që do të ngrihet apo është ngritur para gjykatës së arbitrazhit. Gjykata merr në shqyrtim kërkesën e paraqitur, dhe shprehet me vendim për të.

## **KREU III**

### **PËRBËRJA E GJYKATËS SË ARBITRAZHIT**

#### **Neni 11**

##### **Numri i arbitrave**

1. Palët janë të lira të vendosin mbi numrin e arbitrave. Në mungesë të një vendimi të tillë në marrëveshjen e arbitrazhit, numri i arbitrave duhet të jetë tre.

#### **Neni 12**

##### **Emërimi i arbitrave**

1. Asnjë person nuk përjashtohet për të vepruar si arbitër, për shkak të shtetësisë së tij, përveç kur palët bien dakord ndryshe.
2. Palët janë të lira të bien dakord mbi një procedurë të emërimit të arbitrit ose arbitrave të një komisioni *ad hoc* sipas rregullave procedurale të zgjedhura lirisht nga to ose sipas rregullave të një Institucioni të Përhershëm Arbitrazhi.
3. Në një gjykim arbitrazhi me një arbitër të vetëm, nëse palët janë në gjendje të bien dakord për arbitrin, ai emërohet, me kërkesën e një pale, nga Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit, nëse mosmarrëveshja i është paraqitur këtij Institucioni, ose nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në qoftë se çështja nuk është paraqitur në Institucionin e

Përhershëm të Arbitrazhit ose ky institucion nuk ka miratuar rregullat për emërimin e arbitrave.

4. Personit që i propozohet emërimi si arbitër duhet të shprehë pohimin me shkrim për pranimin e misionit të besuar.
5. Kur, sipas një procedure emërimi të rënë dakord nga palët:
  - a) Një palë nuk vepron siç kërkohet sipas kësaj procedure;
  - b) Palët, ose dy arbitrat, nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje sipas kësaj procedure, ose
  - c) Një palë e tretë qoftë kjo dhe institucion, nuk përmbush asnjë funksion që i është caktuar atij sipas kësaj procedure, secila nga palët pjesëmarrëse në një proces arbitrazhi mund t'i kërkojë gjykatës ose Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit të marrë masat e nevojshme për emërimin e arbitrave, përveç kur marrëveshja mbi procedurat e emërimit parashikon mjete të tjera për të garantuar emërimin.
6. Vendimi i marrë nga Gjykata ose Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin 3 ose 5 të këtij neni nuk i nënshtrohet asnjë apelimi. Gjykata ose Institucioni i Përhershëm i Arbitrazhit, në emërimin e një arbitri, duhet të ketë në konsideratë kualifikimet që kërkohet të ketë një arbitër sipas marrëveshjes së palëve, duke garantuar emërimin e një arbitri të pavarur dhe të paanshëm. Për emërimin e arbitrit të vetëm ose të tretë në rast të zhvillimit një gjykimi arbitrazhi ndërkombëtar duhet kushtuar vëmendje mundësisë së emërimit të një arbitri më shtetësi të ndryshme nga ajo e palëve pjesëmarrëse në gjykim.

### **Neni 13**

#### **Arsyet për të kundërshtuar**

1. Kur nje person është kandidat për t'u caktuar si arbitër, ai duhet të bëjë të ditur çdo rrethanë që lë shkak për një dyshim të justifikueshëm në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e tij. Arbitri, që prej kohës së caktimit të tij dhe gjatë procesit të arbitrazhit duhet t'u bëjë me dije pa vonësë çdo rrethanë të tillë palëve, përveç kur palët kanë qenë të informuara.
2. Nje arbitër mund të kundërshtohet vetëm nëse ekzistojnë rrethana që lidhen me dyshime të justifikuar mbi paanshmërinë ose pavarësinë, ose nëse nuk zotëron kualifikimin për të cilin kanë rënë dakord palët. Njera prej palëve mund të kërkojë përjashtimin e një arbitri të caktuar prej saj, ose në caktimin e të cilit ka marrë pjesë, vetëm kur pala ka marrë dijeni për rrethanat pasi është bërë caktimi.

### **Neni 14**

#### **Procedurat e kundërshtimit të përbërjes së gjykatës së arbitrazhit**

1. Palët janë të lira të përcaktojnë procedurën për kundërshtimin e emërimit të një arbitri sipas dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni.
2. Në mungesë të një marrëveshje pala që kundërshton emërimin e arbitrit duhet t'ia bëjë të ditur gjykatës së arbitrazhit nëpërmjet një deklarate me shkrim, shkaqet e kundërshtimit të arbitrit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni e përbërjes së gjykatës së arbitrazhit apo nga njoftimi i çdo rrethane të referuar në paragrafin 2 të nenit 12. Gjykata e Arbitrazhit vendos për përjashtimin e arbitrit, përveç rasteve kur arbitri që kërkon të kundërshtohet heq dorë nga detyra e ngarkuar ose pala tjetër pranon përjashtimin.

3. Nëse kërkesa për përjashtim bere sipas procedures së rënë dakort prej palëve ose me anë të procedurës së paragrafit (2) të këtij Neni nuk pranohet, pala e interesuar mund t'i kërkojë, brenda 30 ditëve pasi ka marrë njoftimin e vendimit që refuzon përjashtimin, Gjykatës ose Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit, të shprehet në lidhje me kërkesën për përjashtim, dhe ky vendim nuk apelohehet; për sa kohë kërkesa është në shqyrtim e sipër, Gjykata e Arbitrazhit, përfshirë arbitrin që është kërkuar të përjashtohet, vazhdon procesin e arbitrazhit dhe mund të marrë vendim.

### **Neni 15**

#### **Paaftësia dhe/ose pamundësia për të vepruar**

1. Kur një arbitër bëhet *de jure* ose *de facto* i paaftë për të përmbushur funksionet e tij ose për arsye të ndryshme nuk i përmbush detyrat e tij në afatin e caktuar, mandati i tij si arbitër përfundon kur ai tërhiqet nga kjo detyrë ose kur palët merren vesh për përfundimin e kësaj detyre. Në rast se ka një kundërshtim në lidhje me arsyet e pamundësisë së përmbushjes së funksioneve të arbitrit, secila palë mund t'i kërkojë gjykatës ose një Institucioni të Përhershëm të Arbitrazhit të vendosë mbi përfundimin e mandatit të arbitrit. Kundër vendimit të gjykatës apo Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit nuk lejohet ankim.
2. Kur, sipas përcaktimeve të bëra në paragrafin e parë të këtij neni ose atyre të bëra në paragrafin 2 të nenit 14 të këtij ligj, një arbitër heq dorë nga detyra e tij ose njëra prej palëve pranon përfundimin e mandatit të tij, kjo nuk nënkupton pranimin e vlefshmërisë së ndonjë arsye të referuar në këtë nen ose në paragrafin 2 të nenit 13.

### **Neni 16**

#### **Emërimi i një arbitri zëvendësues**

Kur mandati i një arbitri përfundon:

- a) sipas përcaktimeve të bëra në nenin 13 ose 14 të këtij ligji; ose
- b) për shkak të tërheqjes së tij nga detyra; ose
- c) për shkak të revokimit të mandatit të tij sipas marrëveshjes së palëve, ose
- d) për çdo arsye tjetër,

caktohet një arbitër zëvendësues sipas rregullave që zbatohen për emërimin e arbitrit.

## **KREU IV**

### **JURIDIKSIONI I GJYKATËS SË ARBITRAZHIT**

#### **Neni 17**

##### **Kompetenca e gjykatës së arbitrazhit për të vendosur mbi juridiksionin e saj**

1. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë në lidhje me juridiksionin e saj, si dhe në lidhje me çdo kundërshtim apo pavlefshmëri të marrëveshjes së arbitrazhit. Për këtë qëllim, një klauzolë e arbitrazhit e cila është pjesë e një kontrate trajtohet si një marrëveshje e pavarur nga kushtet e tjera të kontratës. Vendimi i marrë nga gjykata e arbitrazhit që deklaron pavlefshërinë e kontratës, nuk sjell *ipso jure* pavlefshërinë e klauzolës së arbitrazhit.

2. Pretendimet për mungesën e juridiksionit të gjykatës së arbitrazhit ngrihet nga palët jo më vonë se data e paraqitjes së prapsimeve me shkrim të palës së paditur. Palët nuk përjashtohen nga e drejta e paraqitjes së një kërkesë të tillë, edhe nëse kanë emëruar, ose kanë marrë pjesë në emërimin e një arbitri. Pretendimet për tejkalimin e kompetencave të gjykatës së arbitrazhit duhet të ngrihen sapo të merret në shqyrtim çështja që pretendohet se është jashtë kompetencave të gjykatës apo tejkalimi i kompetencave konstatohet gjatë procesit të gjykimit të arbitrazhit. Gjykata e arbitrazhit mund, të pranojë paraqitjen e kërkesës, në një kohë të mëvonshme nëse ajo e konsideron vonesën të justifikuar.
3. Gjykata e arbitrazhit mund të vendosë mbi një kërkesë të referuar në paragrafin e dytë të këtij neni qoftë më vendim të ndërmjetëm ashtu dhe me vendim përfundimtar . Nëse gjykata e arbitrazhit vendos me vendim të ndërmjetëm se ka juridiksion, çdo palë mund t'i kërkojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes njoftim të këtij vendimi, gjykatës të përcaktuar në nenin 7 të këtij ligji që të vendosë mbi çështjen e mungesës së juridiksionit.
4. Kërkesa e paraqitur pranë kësaj gjykate nuk pezullon vazhdimin e procedurave të gjykimit të arbitrazhit dhe marrjen e vendimit. Kundër vendimit të gjykatës ose Institucionit të Përhershëm të Arbitrazhit nuk lejohet ankim.

## **Neni 18**

### **Marrja e masave të përkohshme**

1. Gjykata e arbitrazhit, përveç kur palët kanë rënë dakord ndryshe, me kërkesën e njërës prej palëve mund të vendosë marrjen e masave të përkohshme për sigurimin e objektit të padisë.
2. Masa e përkohshme përfshin çdo masë me karakter të përkohshëm, e marrë nga gjykata e arbitrazhit nëpërmjet një vendimi ose në një formë tjetër, në çdo kohë para dhënies së vendimit përfundimtar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, me anë të cilit urdhërohet një palë që të :
  - a. Ruajë *status quo* në pritje të vendimit për zgjidhjen e themelit të mosmarrëveshjes;
  - b. Marrë masa për të parandaluar ose penguar veprimet të cilat me shumë gjasa mund të shkaktojnë një dëm të menjëhershëm apo që mund zhvleftësojnë vetë procedurën e arbitrazhit;
  - c. Sigurojë një mjet për ruajtjen e aseteve, të cilat mund të jenë objekt i një vendimi të ardhshëm; ose
  - d. Ruajë prova dhe materiale që mund të jenë të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

## **Neni 19**

### **Kushtet për dhënien e masave të përkohshme**

1. Pala që kërkon marrjen e një mase të përkohshme sipas parashikimeve të bëra në gërmat “a”, “b” dhe “c” të paragrafit (2) të nenit 17 e bind gjykatën e arbitrazhit që:
  - (a) Dëmi nuk mund të riparohet siç duhet me një vendim dëmshpërblimi nëse masa nuk është urdhëruar, dhe një dëm i tillë kryesisht e tejkalon dëmin që mund t'i rezultojë palës kundër të cilës drejtohet masa nëse masa është dhënë; dhe

- (b) Ka një mundësi të arsyeshme që pala kërkuese e kësaj mase sigurimi do të ketë sukses për themelin e padisë. Vendimi mbi këtë mundësi nuk çënon zgjedhjen e gjykatës së arbitrazhit në marrjen e çdo vendimi të mëvonshëm.
2. Në lidhje me një kërkesë për masë të përkohshme sipas gërmës “d” të paragrafit (2) të nenit 17, dhe gërmave “a” dhe “b” të paragrafit (1) të këtij neni zbatohen vetëm në masën që gjykata e arbitrazhit i konsideron të përshtatshme.

### **Neni 20**

#### **Kërkesat për lëshimin e urdhërave paraprakë dhe kushtet për pranimin e tyre**

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, secila prej palëve, pa njoftuar palën tjetër, mund të bëjë një kërkesë për marrjen e masës së përkohshme me anë të së cilës të të kërkojë që pala tjetër të mos pengojë zbatimin e masës së sigurimit të padisë të kërkuar.
2. Gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një urdhër paraprak, nëse çmon se njoftimi paraprak i kërkesës për masën paraprake ndaj palës kundër të cilës drejtohet, rrezikon të pengojë qëllimin e masës.
3. Kushtet e përcaktuara sipas nenit 18 zbatohen për çdo urdhër të ndërmjetëm, në rast se dëmi që do të vlerësohet sipas gërmës “a” të paragrafit (1) të nenit 18, është dëmi që mund të rezultojë nga marrja ose jo e urdhrit paraprak.

### **Neni 21**

#### **Regjimi specifik për urdhërat paraprak**

1. Pasi gjykata e arbitrazhit të ketë marrë një vendim në lidhje me një kërkesë për një urdhër paraprak, do të njoftojë palët në lidhje me kërkesën për masën e përkohshme, kërkesën për urdhërin e përkohshëm, nëse ka të tillë, dhe të gjitha komunikimet e tjera, duke përfshirë regjistrimin e përmbajtjes së ndonjë komunikimi verbal ndërmjet palëve dhe gjykatës së arbitrazhit.
2. Njëkohësisht, gjykata e arbitrazhit i jep mundësi çdo pale kundër të cilës drejtohet një urdhër i përkohshëm, të paraqesë çështjen e saj sa më shpejt që të jetë e mundur.
3. Gjykata e arbitrazhit do të vendosë menjëherë për çdo kundërshtim ndaj vendimit të ndërmjetëm.
4. Vlefshmëria e urdhrit të përkohshëm përfundon pas 20 (njëzet) ditësh nga data e lëshimit të tij prej gjykatës së arbitrazhit. Megjithatë, gjykata e arbitrazhit mund të lëshojë një masë të përkohshme që miraton ose ndryshon, vendimin e ndërmjetëm, pasi pala kundër të cilës drejtohet urdhëri paraprak, të ketë dhënë njoftim dhe të ketë mundësi për të paraqitur kërkesë padinë e saj.
5. Urdhri i përkohshëm do të jetë detyrues për palët por nuk do t'i nënshtrohet zbatimit nga një gjykatë. Ky urdhër paraprak nuk përbën një vendim.

### **Neni 22**

#### **Ndryshimi, pezullimi, përfundimi**

Gjykata e arbitrazhit mund të ndryshojë, pezullojë ose përfundojë një masë paraprake ose një urdhër të përkohshëm që ka lëshuar, mbi bazën e kërkesës së palës së interesuar dhe në raste të jashtëzakonshme dhe me iniciativën e vet, pasi të ketë njoftuar paraprakisht palët për nisjen e kësaj procedure.

### **Neni 23**

#### **Garancia**



1. Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë palës që kërkon marrjen e një mase të përkohshme të ofrojë garancinë e përshtatshme në lidhje me kërkesën e bërë.
2. Gjykata e arbitrazhit nëse e çmon të përshtatshme ose të nevojshme i kërkon dhënien e garancisë dhe palës që kërkon lëshimin e një urdhëri procedural për sigurimin e padisë në lidhje me masën e natyrën e urdhërit të përkohshëm, me përjashtim të rastit kur kjo gjykatë e konsideron të panevojshme apo të papërshtatshme dhënien e kësaj garancie për shkaqe që lidhen me natyrën e urdhrit.

#### **Neni 24**

##### **Detyrimi për paraqitjen e rrethanave dhe fakteve të mosmarrëveshjes**

1. Gjykata e arbitrazhit mund t'i kërkojë çdo pale që të njoftojë menjëherë palën tjetër, në lidhje me çdo ndryshim material të rrethanave mbi bazën e të cilit është kërkuar apo lëshuar urdhëri i përkohshëm.
2. Pala që kërkon lëshimin e një urdhri të përkohshëm njofton gjykatën e arbitrazhit për të gjitha rrethanat që mund të ndikojnë në marrjen e vendimit nga gjykata e arbitrazhit në lidhje me lëshimin e masës ose urdhrit. Ky detyrim do të jetë në fuqi derisa pala kundër të cilës është kërkuar urdhri, të ketë mundësi për të paraqitur prapësimet dhe qëndrimin e saj për mosmarrëveshjen. Parashikimi i paragrafit të parë të këtij neni do të vazhdojë të jetë në fuqi edhe pas këtij momenti.

#### **Neni 25**

##### **Kostot dhe dëmet**

1. Pala që kërkon lëshimin e urdhrit për marrjen e një mase sigurimi të padisë ose një urdhri paraprak, është përgjegjëse për kostot dhe dëmet e shkaktuara për çdo palë nga masa e sigurimit ose urdhri paraprak procedural, nëse gjykata e arbitrazhit më pas vendos se masa ose vendimi nuk duhet të ishin lëshuar në këto rrethana. Gjykata mund të shprehet në lidhje me përgjegjësinë për pagësen e shpenzimeve dhe dëmit në çdo fazë të gjykimit arbitral.

#### **Neni 26**

##### **Njohja dhe zbatimi**

1. Një masë e përkohshme për sigurimin e padisë e lëshuar nga një gjykatë arbitrazhi njihet si detyruese dhe nëse nuk urdhërohet ndryshe nga gjykata e arbitrazhit, zbatohet pas kërkesës për gjykatën kompetente, pavarësisht nga vendi në të cilin është lëshuar, në bazë të dispozitave të nenit 27.
2. Pala që kërkon ose ka siguruar njohjen ose zbatimin e një mase të përkohshme, do të informojë menjëherë gjykatën për çdo përfundim, pezullim ose ndryshim të asaj mase.
3. Gjykata e Shtetit ku kërkohet njohja ose zbatimi, nëse e çmon të nevojshme, mund të urdhërojë palën kërkuese të ofrojë garancinë e duhur, nëse gjykata e arbitrazhit nuk ka marrë një vendim në lidhje me garancinë ose kur ky vendim është i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të palëve të treta.

#### **Neni 27**

##### **Arsyet për refuzimin e njohjes ose zbatimit**

1. Njohja ose zbatimi i një mase të sigurimit të padisë mund të refuzohet:
  - a) Me kërkesë të palës kundër të cilës drejtohet, nëse gjykata bindet se:
    - i. Ky refuzim kërkohet në bazë të arsyeve të përcaktuara në paragrafin (1), gërma “a”, nënparagrafët “i”, “ii”, “iii” ose “iv” të nenit 47; ose
    - ii. Vendimi i gjykatës së arbitrazhit në lidhje me ofrimin e garancisë mbi masën e sigurimit të padisë të lëshuar nga gjykata e arbitrazhit, nuk është respektuar; ose
    - iii. Masa e sigurimit të padisë është përfunduar ose pezulluar nga gjykata e arbitrazhit, kur autorizohet për këtë nga gjykata e Shtetit në të cilin zhvillohet arbitrazhi, sipas ligjit të të cilit është lëshuar kjo masë; ose
  - b) Nëse gjykata konstaton se:
    - i. Masa e sigurimit të padisë është e papajtueshme me kompetencat e dhëna gjykatës së arbitrazhit dhe gjykata nuk vendos të riformulojë masën e sigurimit, në masën e nevojshme, për t’a përshtatur atë me kompetencat dhe procedurat e veta, për qëllimet e zbatimit të asaj mase dhe pa ndryshuar thelbin e saj; ose
    - ii. Secila prej arsyeve të përcaktuara në nenin 47 paragrafi i parë pika (1), gërma “b” nën paragrafët “i” ose “ii”, zbatohet për njohjen dhe zbatimin e masës së sigurimit të padisë.
2. Çdo vendim i marrë nga gjykata në bazë të ndonjë prej arsyeve të parashikuara në paragrafin parë të këtij neni, do të hyjë në fuqi vetëm për qëllimet e zbatimit për njohjen dhe zbatimin e masës së sigurimit të padisë. Në marrjen e një vendimi, gjykata ku kërkohet njohja ose zbatimi, nuk do të kryejë një rishikim të themelit të masës së sigurimit.

**Neni 28**  
**Masat e sigurimit të padisë të lëshuara**  
**nga gjykata**

1. Gjykatat shqiptare kanë të drejtë të marrin masa për sigurimin e padisë në lidhje me çështje që shqyrtohen në arbitrazh, edhe nëse vendi i zhvillimit të procedurave të arbitrazhit nuk është Republika e Shqipërisë, me kusht që të jenë kompetente për shqyrtimin e tyre sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata duhet t’a përdorë këtë të drejtë në përputhje me karakterin e posaçëm të arbitrazhit ndërkombëtar.

**KREU V**

**ZHVILLIMI I PROCEDIMEVE TË ARBITRAZHIT**

**Neni 29**  
**Trajtimi i barabartë i palëve**

1. Palët trajtohen në mënyrë të barabartë dhe secilës palë i jepet mundësi e plotë për të paraqitur pretendimet e tyre.

**Neni 30**  
**Përcaktimi i rregullave procedurale**

1. Palët janë të lira të bien dakord për procedurën që do të ndiqet nga gjykata e arbitrazhit në zhvillimin e procesit të gjykimit, me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj parashikohet ndryshe.
2. Në pamundësi të arritjes së kësaj marrëveshje/dakordësie, gjykata e arbitrazhit do të zgjedhë rregullat procedurale që vlerëson ajo si të përshtatshme në përputhje me parashikimet e këtij ligji. E drejta e gjykatës së arbitrazhit për të përcaktuar rregullat procedurale pëfshin edhe të drejtën për të pranuar dhe vlerësuar provat e paraqitura në gjykim.

### **Neni 31** **Vendi i arbitrazhit**

1. Palët mund të caktojnë me marrëveshje vendin se ku do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në mungesë të kësaj marrëveshje, vendi i arbitrazhit përcaktohet nga gjykata e arbitrazhit, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, përfshirë lehtësirat për palët.
2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, gjykata e arbitrazhit mund të mblidhet në çdo vend që ajo e çmon të përshtatshëm për kryerjen :
  - a) e konsultimit midis anëtarëve të vet;
  - b) e dëgjimit të dëshmitarëve, ekspertëve ose palëve; ose
  - c) e inspektimit të mallrave, pasurive ose dokumenteve të tjera.

### **Neni 32** **Fillimi i procesit të arbitrazhit**

1. Nëse në marrëveshjen e lidhur midis palëve nuk parashikohet ndryshe, procesi i gjykimit të arbitrazhit në lidhje me një mosmarrëveshje të caktuar, fillon në datën në të cilën kërkesa për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshje para gjykatës së arbitrazhit, i është njoftuar palës së paditur.

### **Neni 33** **Gjuha**

1. Palët kanë të drejtë të zgjedhin me marrëveshje gjuhën ose gjuhët që do të përdoren në procesin e gjykimit të arbitrazhit. Në mungesë të kësaj marrëveshjeje, gjykata e arbitrazhit përcakton gjuhën ose gjuhët që përdoren në këtë proces. Marrëveshje ose vendimi për caktimin e gjuhës, nëse nuk përcaktohet ndryshe, zbatohet dhe:
  - a) për çdo akt procedural të paraqitur nga palët;
  - b) seancat e gjykimeve të arbitrazhit; dhe
  - c) vendimet apo komunikim tjetër të kryer nga gjykata e arbitrazhit.
2. Gjkata e arbitrazhit mund të urdhërojë që çdo provë dokumentuese të shoqërohet nga një përkthim në gjuhën ose gjuhët e caktuara me marrëveshje midis palëve ose të përcaktuara nga gjykata e arbitrazhit.

### **Neni 34** **Parashtresat dhe prapësimet**

1. Brenda periudhës kohore të rënë dakord nga palët ose të përcaktuar nga gjykata e arbitrazhit, paditësi do të parashtrojë faktet që mbështesin kërkesën e tij, çështjet e shtruara për zgjidhje dhe kërkimin përfundimtar, ndërsa i padituri do të paraqesë

mbrojtjen e tij në lidhje me këto çështje, nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe, mbi elementët e këtyre pretendimeve. Palët mund të paraqesin me deklaratat e tyre të gjitha dokumentet që çmojnë të nevojshme ose mund të shtojnë një referencë ndaj dokumenteve ose provave të tjera që paraqesin.

2. Nëse në marrëveshje midis palëve nuk është parashikuar ndryshe, çdo palë mund të ndryshojë ose të shtojë kërkimet, parashtrimet ose mbrojtjen e saj gjatë procesit të gjyimit të arbitrazhit, përveç rasteve kur gjykata e arbitrazhit e çmon të papërshtatshme lejimin e këtij ndryshimi apo shtimi, për shkak se palët nuk kanë respektuar afatin e caktuar nga gjykata e arbitrazhit për t'i paraqitur ato.

### **Neni 35**

#### **Seancat dhe procedurat me shkrim**

1. Me përjashtim të rastit kur palët kanë vendosur ndryshe, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë për zhvillimin e seancave verbale për paraqitjen e dëshmimeve apo për pranimin e argumenteve verbalisht, ose të vendosi për zhvillimin e procesit mbi bazën e dokumenteve dhe të materialeve të tjera. Megjithatë, gjykata e arbitrazhit mund të vendosë të zhvillojë seancë degjimore kur e vlerëson si të arsyeshme ose mbi bazën e kërkesës së njëres prej palëve, me përjashtim të rastit kur palët shprehimisht kanë rënë dakort për moszhvillimin e seancave degjimore.
2. Palëve u bëhet njoftim paraprak për çdo seancë dhe mbledhje të gjykatës së arbitrazhit për qëllime të inspektimit të mallrave, pronave ose dokumenteve të tjera.
3. Të gjitha pretendimet, dokumentet ose informacione të tjera të dhëna gjykatës së arbitrazhit nga një palë, i komunikohen palës tjetër. Gjithashtu palëve i komunikohet çdo raport eksperti ose dokument provues në të cilin gjykata e arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit të saj.

### **Neni 36**

#### **Gjykimi në mungesë**

1. Nëse në marrëveshjen midis palëve nuk është parashikuar ndryshe, pa treguar arsye të mjaftueshme:
  - a) paditësi nuk i komunikon parashtrësën e fakteve dhe të pretendimeve të tij në përputhje me nenin 34 paragrafin (1), gjykata e arbitrazhit mbyll procedurat dhe pushon gjykimin;
  - b) i padituri i komunikon prapësimet e tij të mbrojtjes në përputhje me nenin 34 paragrafin (1), Gjykata e Arbitrazhit vazhdon procedurat duke mos e vlerësuar këtë pamundësi të të paditurit, si pranim nga ana e tij të pretendimeve të paditësit;
  - c) nëse një palë nuk mund të paraqitet në një seancë ose nuk paraqet prova shkresore, gjykata e arbitrazhit mund të vazhdojë procesin e gjyimit dhe të marrë vendimin mbi provat e paraqitura tashmë pranë saj.

### **Neni 37**

#### **Eksperti i caktuar nga gjykata e arbitrazhit**

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, gjykata e arbitrazhit:
  - a) mund të caktojë një ose më shumë ekspertë për t'i raportuar asaj mbi çështje specifike që do të përcaktohen nga gjykata e arbitrazhit;

- b) mund t'i kërkojë një pale t'i japë ekspertit çdo informacion përkatës ose të përgatisë, ose garantojë akses në dokumente, mallra ose pasuri të tjera për inspektim nga ana e tij.
2. Nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, me kërkesë të një pale ose nëse gjykata e arbitrazhit e çmon të nevojshme, eksperti, pas paraqitjes së raportit të tij me shkrim ose verbal, do të marrë pjesë në një seancë ku palët kanë mundësi t'i bëjnë atij pyetje dhe të paraqesin dëshmitarët ekspertë për të dëshmuar mbi çështjet në fjalë.

### **Neni 38**

#### **Ndihma e gjykatës në marrjen e provave**

1. Gjkata e arbitrazhit ose një palë me miratimin e gjykatës së arbitrazhit, mund të kërkojnë ndihmë një gjykatë kompetente për marrjen ose sigurimin e provave. Gjkata mund të ekzekutojë kërkesën brenda kompetencës së saj dhe sipas rregullave për marrjen e provave.

## **KREU VI**

### **MARRJA E VENDIMIT DHE PËRFUNDIMI I PROCEDURAVE**

#### **Neni 39**

##### **Rregullat e zbatueshme për thelbin e mosmarrëveshjes**

1. Për arbitrazhin ndërkombëtar, gjykata e arbitrazhit do të vendosë për mosmarrëveshjen në përputhje me ato rregulla të ligjit të zgjedhur nga palët, të zbatueshëm për thelbin e mosmarrëveshjes. Çdo përcaktim i ligjit ose sistemit ligjor të një Shteti të caktuar interpretohet, nëse nuk është rënë dakord ndryshe, sikur i referohet drejtpërdrejt ligjit material të atij Shteti dhe jo rregullave të tij për të drejtën ndërkombëtare private.
2. Për qëllime të paragrafit (2) të këtij neni, në mungesë të marrjes së një vendimi nga palët, gjykata e arbitrazhit do të zbatojë ligjin e përcaktuar nga rregullat e të drejtës ndërkombëtare private që ajo vlerëson si të zbatueshëm.
3. Gjkata e arbitrazhit do të vendosë *ex aequo et bono* ose si *amiable compositeur*, vetëm nëse palët kanë lejuar këtë gjë shprehimisht.
4. Në të gjitha rastet, gjykata e arbitrazhit do të vendosë në përputhje me kushtet e kontratës dhe do të marrë në konsideratë zakonet tregtare të zbatueshme për transaksionin.

#### **Neni 40**

##### **Marrja e vendimit nga trupi i arbitrave**

1. Në procedurat e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i gjykatës së arbitrazhit do të merret nëse nuk bihet dakord ndryshe nga palët, me shumicë të të gjithë anëtarëve të saj. Megjithatë, çështjet e procedurës mund të vendosen nga një arbitër kryesues, nëse kjo autorizohet nga palët ose të gjithë anëtarët e gjykatës së arbitrazhit.

#### **Neni 41**

##### **Zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim**

1. Nëse gjatë procedurave të arbitrazhit palët zgjidhin mosmarrëveshjen me mirëkuptim, gjykata e arbitrazhit do të përfundojë procesin dhe, nëse kërkohet nga palët dhe nuk kundërshtohet nga gjykata e arbitrazhit, do të regjistrojë marrëveshjen në formën e një vendimi arbitrazhi në bazë të kushteve të rëna dakord nga palët.
2. Një vendim i marrë në bazë të kushteve të rëna dakord nga palët duhet të merret në përputhje me dispozitat e nenit 42 dhe shpallet si vendim i gjykatës së arbitrazhit. Ky vendim ka efekt të njëjtë me çdo vendim tjetër të marrë mbi themelin e çështjes.

#### **Neni 42**

#### **Forma dhe përmbajtja e vendimit**

1. Vendimi hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga arbitri ose arbitrat. Në procedimet e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, nënshkrimet e shumicës të të gjithë anëtarëve të gjykatës së arbitrazhit do të jenë të mjaftueshme, me kusht që të deklarohet arsyeja për çdo nënshkrim që mungon.
2. Vendimi përfundimtar i arbitrazhit duhet të jetë i arsyetuar, me përjashtim të rasteve kur palët kanë rënë dakord që të mos jetë i arsyetuar ose vendimi është një vendim arbitrazhi në bazë të kushteve të rëna dakord sipas parashikimeve të bëra në nenin 41.
3. Vendimi i arbitrazhit duhet të ketë të përcaktuar datën dhe vendin e arbitrazhit, siç përcaktohet në paragrafin e parë të nenit 31 të këtij ligji. Vendimi konsiderohet të jetë marrë në atë vend.
4. Pas marrjes së vendimit, një kopje e nënshkruar nga arbitrat në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, i dorëzohet secilës palë.

#### **Neni 43**

#### **Përfundimi i procedimeve**

1. Procedurat e arbitrazhit përfundojnë me marrjen e një vendimi të formës së prerë ose një urdhër të gjykatës së arbitrazhit të marrë, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni.
2. Gjkata e arbitrazhit lëshon urdhër për mbylljen e procedurave të arbitrazhit kur:
  - a) paditësi tërheq padinë në qoftë se i padituri nuk e kundërshton këtë tërheqje, dhe gjykata e arbitrazhit nuk njeh një interes të ligjshëm të tij në arritjen e një zgjidhje përfundimtare të mosmarrëveshjes;
  - b) palët bien dakord për përfundimin e procedurave;
  - c) gjykata e arbitrazhit konstaton se vazhdimi i procedurave, për arsye të tjera, është bërë i panevojshëm ose i pamundur.
3. Mandati i gjykatës së arbitrazhit përfundon me përfundimin e procedurave të arbitrazhit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 44 dhe paragrafin (4) të nenit 45.

#### **Neni 44**

#### **Korrigjimi dhe interpretimi i vendimit të arbitrazhit, vendimi shtesë i arbitrazhit**

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit të arbitrazhit, nëse palët nuk kanë rënë dakord ndryshe për ndonjë afat tjetër kohor,
  - a) një palë duke njoftuar palën tjetër, mund t'i kërkojë gjykatës së arbitrazhit të korrigjojë në vendimin e arbitrazhit gabimet në llogaritje, gabimet ortografike ose tipografike ose çdo gabim të një natyre të ngjashme:

- b) nëse bihet dakord për këtë nga palët, një palë duke njoftuar palën tjetër, mund t'i kërkojë gjykatës së arbitrazhit të bëjë interpretim të një pike specifike ose pjesë të vendimit;
2. Nëse gjykata e arbitrazhit çmon se kërkesa është e bazuar, ajo bën korrigjimin ose jep interpretimin brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës. Interpretimi bëhet pjesë e vendimit përfundimtar të arbitrazhit.
  3. Gjukata e arbitrazhit me iniciativën e vet mund të korrigjojë çdo gabim të natyrës së parashikuar në gjermën "a" të paragrafit të parë të këtij neni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit.
  4. Nëse nga palët nuk është rënë dakord ndryshe, një palë, pas njoftimit të palës tjetër, mund të kërkojë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e vendimit, që gjykata e Arbitrazhit të marrë një vendim shtesë në lidhje me pretendimet e paraqitura në procesin e arbitrazhit por që nuk janë përfshirë në vendim. Nëse gjykata e arbitrazhit e vlerëson kërkesën të bazuar, ajo merr vendim shtesë brenda një periudhe prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh.
  5. Gjukata e arbitrazhit mund të shtyjë, nëse është e nevojshme, periudhën kohore brenda të cilës do të bëjë korrigjimin, interpretimin ose marrjen e një vendimi shtesë sipas paragrafit të parë ose të tretë të këtij neni.
  6. Dispozitat e nenit 42 zbatohen si për korrigjimin ose interpretimin e vendimit të arbitrazhit ashtu dhe vendimin shtesë.

## **KREU VII**

### **ANKIMI KUNDËR VENDIMIT**

#### **Neni 45**

#### **Kërkesa për anullimin si ankim ekskluziv kundër vendimit të arbitrazhit**

1. Ankimi në gjykatë kundër një vendimi arbitrazhi mund të bëhet vetëm me anë të paraqitjes së një kërkesë për anulim, në përputhje me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni.
2. Një vendim arbitrazhi mund të priset nga Gjukata e Apelit e Tiranës vetëm nëse:
  - a. Pala që bën kërkesën dhe provon se:
    - i. ka qenë në kushtet e një pavlefshmërie të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji ; ose marrëveshja e mësipërme nuk është e vlefshme sipas ligjit të cilit i nënshtrohen palët ose, në mungesë të kushteve të parashikuara në legjislacionin shqiptar: ose
    - ii. nuk është bërë njoftimi i duhur për caktimin e një arbitri ose për fillimin e procedurës së arbitrazhit apo kur për ndonjë arsye tjetër nuk ka patur mundësi të paraqiste pretendimet e saj në lidhje me mosmarrëveshjen; ose
    - iii. vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar ose që nuk përfshihet në termat e marrëveshjes për t'iu nënshtuar arbitrazhit, ose përmban vendime mbi çështje jashtë objektit të referimit në arbitrazh, me kusht që vendimet mbi çështjet e referuara në arbitrazh mund të ndahen nga vendimet mbi çështje që nuk referohen në arbitrazh dhe në këto raste vetëm ajo pjesë e vendimit që përmban vendime mbi çështjet që nuk referohen në arbitrazh, mund të priset; ose
    - iv. përbërja e gjykatës së arbitrazhit apo procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në përputhje me marrëveshjen e palëve, përveç rasteve kur kjo marrëveshje bie në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nga e cila palët nuk mund të derogojnë,

ose, në mungesë të kësaj marrëveshjeje, nuk ka qenë në përputhje me këtë ligj;  
ose

b. Gjykata vëren se:

- i. çështja, objekt i mosmarrëveshjes nuk mund të jetë objekt i gjykimit nëpërmjet arbitrazhit sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë; ose
  - ii. vendimi është në kundërshtim me politikën publike të Republikës së Shqipërisë.
3. Kërkesa për prishjen e vendimit nuk mund të bëhet pas kalimit të afatit 3 (tre) mujor nga data kur palës që ka bërë kërkesën i është dhënë vendimi ose, nëse kur është paraqitur një kërkesë sipas nenit 34 të këtij ligji, nga data e paraqitjes së kësaj kërkesë para gjykatës së arbitrazhit.
4. Në raste kur kërkohet prishja e vendimit nga njëra prej palëve, gjykata mund të pezullojë procesin gjyqësor për një periudhë kohore të përcaktuar me qëllim që t'i japë gjykatës së arbitrazhit mundësi për të rifilluar procesin e arbitrazhit ose për të marrë masa të tjera të tilla të nevojshme që sipas gjykimit të gjykatës së arbitrazhit, do të eliminojnë shkaqet për shfuqizim.

## **KREU VIII**

### **NJOHJA DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË ARBITRAZHIT**

#### **Neni 46**

##### **Njohja dhe zbatimi**

1. Një vendim arbitrazhi, pavarësisht nga vendi në të cilin është marrë, është i detyrueshëm për zbatim mbi bazën e kërkesës së paraqitur me shkrim para gjykatës kompetente, sipas dispozitave të këtij neni dhe nenit 47 të këtij ligji. Vendimet e marra sipas një procedure arbitrazhi të zhvilluar në Republikën e Shqipërisë përbëjnë titull ekzekutiv në bazë të dispozitave të nenit 47 të këtij ligji, dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
2. Pala gjyqfituese e një vendimi arbitrazhi apo pala që kërkon zbatimin e tij, duhet të paraqesë kopjen origjinale apo një kopje të njësuar me origjinalin të vendimit të arbitrazhit dhe marrëveshjes fillestare të arbitrazhit të përmendur në nenin 8 të këtij ligji. Nëse vendimi ose marrëveshja nuk janë hartuar në gjuhën shqipe, pala duhet të sigurojë një përkthim të vërtetuar të tyre në këtë gjuhë.

#### **Neni 47**

##### **Arsyet për refuzimin e njohjes ose zbatimit të vendimeve**

1. Njohja ose zbatimi i një vendimi arbitrazhi, pavarësisht nga Shteti në të cilin është marrë, mund të refuzohet vetëm për një nga arsyet e mëposhtme :
  - a) me kërkesën e palës kundër të cilës është dhënë vendimi, nëse kjo palë i dorëzon gjykatës kompetente para së cilës është kërkuar njohja ose zbatimi i vendimit, prova se:
    - i. njëra nga palët e marrëveshjes së arbitrazhit është në kushtet e paaftësisë së parashikuar në nenin 8 të këtij ligji; ose marrëveshja e mësipërme nuk është e vlefshme sipas ligjit të cilit i janë nënshtruar palët, ose në mungesë të kësaj marrëveshjeje sipas ligjit të vendit ku është marrë vendimi; ose



- ii. pala kundër të cilës është marrë vendimi, nuk është njoftuar në mënyrën e duhur për emërimin e një arbitri ose për procedurat e arbitrazhit; ose
  - iii. vendimi lidhet me një mosmarrëveshje që nuk kërkohet apo nuk përfshihet në kushtet e marrëveshjes për t'iu nënshtruar arbitrazhit, ose përmban vendime mbi çështje përtej atyre që palët kanë rënë dakord t'ia nënshtrojnë arbitrazhit, me kusht që, nëse vendimet për çështjet që i janë nënshtruar zgjidhjes me arbitrazh të mund të ndahen nga ato çështje që nuk i janë nënshtruar arbitrazhit, pjesa e vendimit mbi çështje që i janë nënshtruar arbitrazhit mund të njihet dhe të zbatohet; ose
  - iv. përbërja e gjykatës së arbitrazhit ose procedurat e arbitrazhit nuk kanë qenë në përputhje me marrëveshjen e palëve ose, në mungesë të kësaj marrëveshjeje, ato nuk ka qenë në përputhje me këtë ligj ose me legjislacionin e vendit ku është zhvilluar arbitrazhi; ose
  - v. vendimi i arbitrazhit nuk ka ende fuqi detyruese ndërmjet palëve ose është prishur ose pezulluar nga një gjykatë e vendit në të cilin ose sipas legjislacionit të të cilit, është dhënë ai vendim; ose
- b) Gjykata e Apelit të Tiranës konstaton se:
- i. çështja objekt i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet me arbitrazh sipas legjislacionit shqiptar; ose
  - ii. njohja ose zbatimi i vendimit do të ishte në kundërshtim me politikën publike të Republikës së Shqipërisë .
2. Nëse i bëhet kërkesë Gjykatës për prishjen ose pezullimin e një vendimi arbitrazhi është paraqitur para një gjykatë sipas parashikimeve të bëra në nënparagrafin “v” të gërmës “a” të paragrafit (1) të këtij neni kjo e fundit, nëse e çmon të nevojshme, mund të shtyjë njohjen e vendimit dhe gjithashtu, me kërkesë të palës që kërkon njohjen ose zbatimin e vendimit, mund të urdhërojë palën tjetër të ofrojë garancinë e përshtatshme për zbatimin e tij.

#### **Neni 48** **Dispozitat tranzitore**

1. Dispozitat e këtij ligji do të jenë të zbatueshme për marrëveshjet e arbitrazhit vendas për aq kohë sa nuk bien në kundërshtim me dispozitat e neneve 400- 438 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### **Neni 49** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.